



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/A32 – 7 Prot.
K3/E12 – 7 Prot.
Nr. Dok. 202500186/7
202500033/7

Tiranë 11/07/2025

Lënda: Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Bashkisë Sarandë për moskthim përgjigje ndaj kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit

BASHKISË

SARANDË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesë/kërkesë të z. A. O. dhe E. M. të paraqitura në vitin 2023 në kohë të ndryshme, banues në qytetin e Sarandës.

Objekti i ankesës është i njëjtë për të dy ankuesit, të cilët ankohen për mosveprime të bashkisë për problematikat që kanë në objektin, në bashkëpronësi, pallat ku jetojnë. Përkatesisht z. A.O. është banor në lagjen nr.4, Kodër, në Sarandë dhe z. E.M. banor në lagjen nr.1, rruga "Mitro Dhimetrika", pallati nr.26, në Sarandë. Shqetësimet që kanë parashtruar në ankesë si përfaqësues edhe të banorëve të tjerë bashkëpronarë, i kanë adresuar pranë Bashkisë Sarandë, por pa asnjë zgjidhje. Problematika në të dyja rastet ka të bëjë me sjelljet abuzive që janë bërë nga persona të caktuar të cilët kanë tejkaluar limitet e përdorimit të hapësirave të përbashkëta, duke u kthyer në përdorues abuziv për interesa ngushtësisht vetjake.

Duke u gjendur përballë mosveprimit të strukturave të ngarkuara, të Bashkisë Sarandë, për rregullimin dhe administrimin e problematikave që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë, në pallat, ankuesit i janë drejtuar institucionit tonë.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18, shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes¹.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe nenit 19 shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa Bashkisë Sarandë, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje deri më sot.

Konkretisht, për rastin e z. A.O., shkresat nr. K3/A32 – 2 prot., datë 30.11.2023, "*Kërkesë për shpjegime*", nr. K3/A32 – 4 prot., datë 25.06.2024, nr. K3/A32 – 5 prot., datë 31.10.2024 dhe nr. K3/A32 – 6 prot., datë 20.01.2025 "*Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion*" drejtuar Bashkisë Sarandë.

Ndërsa për rastin e z. E.M., shkresat nr. K3/E12 – 2 prot., datë 13.02.2024, "*Kërkesë për shpjegime*", nr. K3/E12 – 4 prot., datë 27.06.2024, nr. K3/E12 – 5 prot., datë 31.10.2024 dhe nr. K3/E12 – 6 prot., datë 20.01.2025 "*Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion*" drejtuar Bashkisë Sarandë.

Edhe pse tashmë Avokati i Popullit ka dërguar 4 (katër) shkresa në organin tuaj publik, për secilin ankues, ku kërkohen shpjegime mbi trajtimin e problematikës së paraqitur, përsëri sot e kësaj dite nuk ka asnjë përgjigje dhe asnjë reagim zyrtar nga ana juaj duke krijuar kështu një situatë të pazakontë, e cila ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e institucionit tonë.

Efektivisht sot, pas 1 viti e 5 muaj, vazhdimi i shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e Avokatit të Popullit është pamundësuar nga mungesa e gatishmërisë dhe e bashkëpunimit prej personave përgjegjës në Bashkinë Sarandë, për dhënien e shpjegimeve të kërkuara.

¹ Neni 13 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur verën ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*"

Në rrethanat e parashtruara sa sipër ju bëjmë me dije se kjo situatë përbën shkelje flagrante të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, si dhe të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Mos dërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankuesve. Ky qëndrim i mbajtur nga organi juaj me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesve.

Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Më konkretisht neni 63 parashikon se: *“1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. **Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.***

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentet ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63, pikat 1, 2 dhe 3, të Kushtetutës parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozime për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës. Gjithashtu, edhe ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.*

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3, i këtij të fundit parashikon se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të unitetit dhe hierarkisë;*

llogaridhënies; dekoncentrimin; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, evidencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin". Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol "kontrollues" mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t'u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, edhe lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu, minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore, ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian, por edhe atë të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ, është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Po ashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se bashkëpunimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit është identifikuar si një nga elementët matës për vlerësimin e ecurisë së shoqërisë në kapitullin 23, përgjatë negociatave me BE.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, në rast se edhe pas këtij rekomandimi nuk mundësohet marrja e masave të nevojshme organizative për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës me Institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të dërguara nga Institucioni ynë, ju bëjmë me dije se nga ana jonë do të paraqiten materialet përkatëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Sarandë, në përputhje me nenin 248, të Kodit Penal për "Shpërdorim detyrë",

pasi vlerësojmë se Bashkia Sarandë, është përgjegjëse për mosveprimin, apo për mungesën e dhënies së përgjigjeve përkatëse.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Bashkia Sarandë, titullari i kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore, të vlerësojë në përputhje me ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me legjislacionin aktual.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1, të ligjit nr. 8454/1999, në të cilin parashikohet se:

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,

REKOMANDOJMË:

- 1. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
- 2. Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Bashkisë Sarandë, lidhur me mospërmblidhjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
- 3. Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë si dhe masat disiplinore që do të merrni na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

Erinda MELI

d.v